



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (i rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

Teknik (Sekondarist) në Sektorin e Mirëmbajtjes së Nënstacioneve, Njësia Operative Fier (NJOF)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollon dhe teston mbrojtjet rele për fiderat 10 kV 20 kV dhe 35 kV vete ose se bashku me specialistet e SMR duke vënë në dijeni shefin e sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve.
- Kontrollon gjëndjen dhe raporton në mënyre periodike për reletë e nënstacioneve nën varësi.
- Realizon modifikime teknike të nevojshme në skemat sekondare me orientimin e SMR, vë në dijeni shefin e sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve.
- Kryen riparime të mundshme të releve të dëmtuara së bashku me SMR.
- Analizon avaritë e përditëshme në nënstacionet e njësisë operative dhe raporton pranë SMR dhe shefit të sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve.
- Jep sugjerime për zëvendësime relesh, modifikime skemash sipas nevojave.
- Mban një grafik të detajuar të remonteve të mbrojtjeve rele si dhe për avarite për çdo mbrojtje.
- Merr detyra nga përgjegjësi i sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve /shef Sektorit të Mbrojtjes Rele pranë DRRT /DSHMT.
- Merr pjesë në zgjidhjen e avarive që mund të ndodhin bashkë me specialistet e SMR, njofton shefin e sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve.
- Është përgjegjës për sistemet e mbrojtjes rele në nënstacion dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së sistemeve DC dhe te rrymes vazhduar.
- Përgjigjet për mbarvajtjen e sistemit të mbrojtjes rele në nënstacionet 110 kV që i janë caktuar nga njësia operative (për pjesën që është aset i OST)



Kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati për punësim:

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara;
- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë;
- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 2 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.

ARSIMI I KËRKUAR:

I mesem elektrik

Dokumentat për dorëzim

Faza e Vlerësimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: info@ost.al, këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë e arsimit të mesëm
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.



Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Dokumentat për dorëzim

Faza e lidhjes së kontratës:

1. Libreza e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore
2. Fotokopje e noterizuar e dëftesës sëbashku me listen e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata
7. Vërtetim nga prokuroria
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi

###